



Institute
for Democracy
and Mediation

BREZI I RREZIKUAR

**Rritja e Dhunës mes të Rinjve
në Shqipëri**

Romario Shehu

Të dhënat aktuale në Shqipëri tregojnë një tendencë në rritje të përfshirjes së të rinjve në dhunë dhe sjellje kriminale, duke reflektuar tendencat e ngjashme që vërehen në të gjithë Evropën dhe më gjerë. Në përgjigje të saj, institucionet shtetërore në Shqipëri kanë marrë masa të tilla si angazhimi i oficerëve të sigurisë në shkolla, paketa e “Sigurisë në Shkollë” dhe planet për instalimin e kamerave të monitorimit në shkolla. Megjithatë, këto përpjekje mbeten të fragmentuara dhe afatshkurtra. Trajtimi i sigurisë së të rinjve në një mënyrë të qëndrueshme kërkon së pari një qasje sistemike të bazuar në të dhëna, e cila shqyrton format, shkaqet rrënjësore, si dhe faktorët që kontribuojnë në dhunën mes të rinjve dhe veprave penale të pa-raportuara, veçanërisht brenda dhe përreth shkollave. Një kuptim gjithëpërfshirës i këtyre dinamikave, i shoqëruar me koordinim më të fortë institucional, investimin në masat parandaluese dhe promovimin e qëndrueshmërisë së të rinjve, është kyç për të siguruar një mjedis më të sigurt dhe gjithëpërfshirës për të rinjtë e Shqipërisë.

1. HYRJE

Siguria e të rinjve në Shqipëri po përballlet me një krizë në zhvillim, e shoqëruar nga nivele në rritje të dhunës dhe sjelljeve kriminale që përfshijnë të mitur, veçanërisht brenda dhe përreth mjediseve shkollore. Kjo tendencë shqetësuese në Shqipëri kulmoi me dy incidente fatale në vitet e fundit, ku secili ilustron nivelin e kërcënimit dhe mangësitë institucionale që lejojnë që kjo lloj dhuna të vazhdojë.

Në maj të vitit 2023, një nxënës 15-vjeçar u qëllua për vdekje në qytetin e Gramshit pas një konflikti që raportohet të jetë shkaktuar nga bisedat në rrjetet sociale. Në të njëjtin konflikt u plagos rëndë edhe kushëriri i të ndjerit. Të gjithë të dyshuarit e përfshirë ishin të mitur, me moshë nga 14 deri në 15 vjeç, çka tregon edhe normalizimin shqetësues të dhunës mes të miturve. Vetëm një vit më vonë, në nëntor të vitit 2024, një ngjarje e ngjashme ndodhi në Tiranë, kur një nxënës 14-vjeçar qëllloi për vdekje një shok të klasës jashtë ambienteve të shkollës pas një grindjeje verbale të përshkallëzuar. Pavarësisht se shkolla kishte një oficer sigurie, si dhe shenjave të qarta paralajmëruese, aty nuk u morën masa parandaluese. Autori i ngjarjes më pas publikoi foto që lavdëronin aktin në rrjetet sociale, duke reflektuar kështu një sjellje të re dixhitale ku lavdërohet dhuna dhe nxiten sjelljet e dhunshme.

Këto nuk janë incidente të izoluara, përkundrazi, ato janë simptoma të mangësive më të thella sistemike: mekanizmave të dobët të parandalimit dhe zgjidhjes së konflikteve,

Brezi i Rrezikuar: Rritja e Dhunës mes të Rinjve në Shqipëri

mbikëqyrjes së pamjaftueshme në mjediset shkollore, shërbimeve të kufizuara të mbështetjes psikologjike dhe ndikimit të pakontrolluar të platformave digjitale në formësimin e sjelljes së të rinjve. Së bashku, këta faktorë kontribuojnë në një mjedis të rrezikshëm ku dhuna, përveçse është duke u shtuar, ngelet edhe e pa-trajtuar.

2. GJENDJA AKTUALE

Të dhënat nga institucionet e drejtësisë konfirmojnë nivelin e kësaj tendence në rritje e dhunës mes të rinjve. Në vitin 2024, Prokuroria e Përgjithshme e Shqipërisë regjistroi 835 procedime penale ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin—më shumë se dyfishi i numrit të raportuar në vitin 2019 (397 procedime).¹ Veprat penale të kryera nga të miturit përfshijnë kryesisht vjedhjen e pasurisë dhe drejtimin e automjeteve në mënyrë të parregullt, megjithatë, sa vjen e më tepër po përfshijnë edhe vepra më të rënda të tilla si veprat penale të lidhura me narkotikët, prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve, si dhe veprat penale kundër personit. Kështu, të miturit përbëjnë 7.38% të të pandehurve për veprën penale “krime kundër jetës të kryer me dashje” në vitin 2024, ndërkohë që në vitin 2019 të miturit përbënin vetëm 1% të të pandehurve për këtë vepër penale. Ndaj 27 të miturve është vendosur masë sigurimi arrest në burg në vitin 2024, ndërsa në vitin 2019 e njëjta masë është vendosur për 39 të mitur.² Të gjitha këto reflektojnë përfshirjen në rritje të të rinjve në sistemin e drejtësisë penale në Shqipëri.

Tendenca të ngjashme vërehen në të gjithë Evropën. Përtej akteve të izoluara të dhunës, të rinjtë në Evropë po tërhiqen gjithashtu nga strukturat e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Një raport i EUROPOL në vitin 2025 tregon se të miturit në Evropë po rekrutohen përmes rrjeteve sociale dhe platformave të mesazheve të enkriptuara, të cilat shfrytëzojnë anonimitetin dhe targetojnë adoleshentët me mesazhe të përshtatura me kujdes.³ Këto rrjete sociale shpesh lartësojnë dhunën dhe pasurinë materiale, duke shfrytëzuar cënueshmërinë e të rinjve dhe mundësitë e kufizuara ekonomike. Studimet e zhvilluara në Shqipëri konfirmojnë se të rinjtë nga 14 deri në 23 vjeç janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj rekrutimit, të shtyrë nga një përzierje faktorësh personalë, familjarë dhe social-ekonomikë.⁴

¹ Raportet Vjetorë të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri." Marrë nga https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/

² Të dhënat janë marrë nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm nëpërmjet një kërkesë për informacion, 2 maj, 2025.

³ EUROPOL, “Ndryshimi ADN-së së krimit të organizuar dhe krimeve të rënda,” 2025. Marrë nga <https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/EU-SOCTA-2025.pdf>

⁴ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (2018). Përkufizimi i rekomandimeve për një pilot që synon të ndalojë dhe të largojë individët nga përfshirja në Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar në Shqipëri.

Përveç shqetësimeve në rritje rreth krimit të organizuar, në Evropë (dhe përtej saj) po dëshmohet një rritje shqetësuese e numrit të të miturve të përfshirë në vepra të ekstremizmit të dhunshëm.⁵ Ndërkohë që radikalizimi i të rinjve nuk është një fenomen i ri, tendenca aktuale tregon një risi shqetësuese, ku ata që radikalizohen janë gjithnjë e më të rinj, ku disa individë të akuzuar për vepra penale të lidhura me terrorizmin janë vetëm 15 vjeç ose edhe më të vegjël.⁶ Për më tepër, fenomeni po arrin nivele të paprecedente (duke arritur rreth 20-30% të numrit total të hetimeve ndaj terrorizmit në disa shtete).⁷ Ky fenomen hap një kapitull të ri dhe shqetësues të radikalizimit të të rinjve. Strategjia e Shqipërisë kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm gjithashtu pranon shqetësimin në rritje të radikalizimit të të rinjve. Strategjia thekson se të rinjtë e papunë apo të izoluar mund të jenë të cenueshëm nga propaganda e ideologjive ekstremiste që mbrojnë përdorimin e dhunës për të protestuar kundër rendit ekzistues dhe për të bërë të mundur ndryshimet e dëshiruara si dhe për përfitime personale.⁸ Studimet në Shqipëri tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve ndihen të shkëputur nga shoqëria dhe të prirur drejt sjelljeve të rrezikshme.⁹ Një gjendje e tillë mund të rrisë mundësitë për ndërhyrje nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat ofrojnë ndjesinë e qëllimit në jetë.¹⁰

Si përgjigje ndaj shqetësimeve në rritje për sigurinë e të rinjve, qeveria shqiptare ka ndërmarrë disa hapa të nevojshëm për të ulur këto kërcënime. Në vitin 2018, Shqipëria prezantoi projektin e “Oficerëve të Sigurisë në Shkollë”—profesionistë të trajnuar, të cilët kanë studiuar psikologji, pedagogji, ose punë sociale.¹¹ Ndryshe nga Policia e Shtetit, këta oficerë shërbejnë si ndërmjetës midis nxënësve, mësuesve, prindërve dhe organeve të rendit. Roli i tyre përqendrohet në trajtimin e dhunës, problemeve të lidhura me lëndët narkotike dhe çështjeve disiplinore, ndërkohë që promovojnë një

⁵ Dr. Thomas Renard (2025), “Radikalizimi i Adoloshentëve: Nuk është thjesht në Netflix,” Komisioni Evropian, marrë nga <https://ec.europa.eu/newsroom/home/items/880571/en>

⁶ Po aty.

⁷ Po aty.

⁸ Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025, fq 27, marrë nga <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Strategjia-CT-CVE-2023-2025-vkm-81-14-02-2023.pdf>

⁹ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, “Vlerësimi i Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri 2024,” fq. 108, marrë nga <https://idmalbania.org/publication-cpt/the-2024-assessment-of-violent-extremism-in-albania/>

¹⁰ Po aty.

¹¹ Kryeministria (2018), “Oficerët e Sigurisë në Shkollë” – Projekti më i ri për rritjen e sigurisë në shkollë,” <https://www.kryeministria.al/newsroom/security-officers-schools-newest-programme-enhance-school-safety/>

Brezi i Rrezikuar: Rritja e Dhunës mes të Rinjve në Shqipëri

mjedis të sigurt dhe mbështetës si brenda ashtu edhe jashtë klasës. Ata lehtësojnë komunikimin mes nxënësve, stafit, familjeve dhe, kur është e nevojshme, koordinojnë drejtpërdrejt me policinë.¹² Numri i këtyre oficerëve është rritur gradualisht, duke arritur tashmë në 270, si dhe duke zgjeruar prezencën e tyre edhe në arsimin profesional.¹³ Pavarësisht këtyre përpjekjeve, shqetësimet rreth sigurisë në shkolla janë sërish aty dhe kanë nevojë për vëmendje të vazhdueshme.

Qeveria ka prezantuar gjithashtu paketën e “Sigurisë në Shkolla” në vitin 2023, e cila ka për qëllim të përmirësojë sigurinë e fëmijëve jo vetëm brenda ambienteve shkollore, por edhe në perimetrin e tyre.¹⁴ Objektivi kryesor i kësaj nisme është parandalimi i kriminalitetit dhe i përdorimit të substancave narkotike në radhët e të rinjve, si dhe goditja e rrjetit të shpërndarjes së drogës në perimetrin e sigurisë së shkollës.¹⁵ Për më tepër, paketa parashikon bashkëpunim ndër-institucional, duke përfshirë agjenci si Agjencia Kombëtare e Ushqimit, bashkitë, si dhe operatorët e shëndetit dhe inspektorët e ndërtimit, për të siguruar sigurinë e ushqimit, kushtet higjienike dhe përputhshmërinë strukturore brenda kufijve të përcaktuar të sigurisë shkollore.¹⁶ Ndërkohë që paketa e “Sigurisë në Shkolla” parashikon hapa të rëndësishëm në përmirësimin e sigurisë, sërish ngelet e nevojshme një qasje më gjithëpërfshirëse dhe proaktive, e cila do të ndihmojë përpjekjet ekzistuese duke përfshirë një analizë më të thellë të krimeve mes të rinjve për të informuar dhe udhëhequr strategjitë e ardhshme të orientuara drejt parandalimit.

¹² Po aty.

¹³ Ministria e Arsimit (2025), “Certifikohen 77 oficerë të rinj sigurie, Manastirliu: Rrisim në 400 numrin e oficerëve të sigurisë në shkolla, për herë të parë edhe në arsimin profesional,” <https://arsimi.gov.al/en/newsroom/certifikohen-77-oficere-te-rinj-sigurie-manastirliu-rrisim-ne-400-numrin-e-oficereve-te-sigurise-ne-shkolla-per-here-te-pare-edhe-ne-arsimin-profesional/>

¹⁴ Agjencia Telegrafike Shqiptare (2023), “Paketa e “Sigurisë në shkolla”, Balla: Objektiv, parandalimi i kriminalitetit tek të rinjtë,” <https://ata.gov.al/2023/12/18/paketa-siguria-ne-shkolla-balla-objektiv-parandalimi-i-kriminalitetit-tek-te-rinjte/>

¹⁵ Ministria e Brendshme (2024), “Konferenca Kombëtare “Shkolla, Qendër Komunitare”/Ministri Hoxha: Punojmë së bashku për të ndërtuar shkolla e institucione të sigurta,” marrë nga <https://arkiva.mb.gov.al/konferenca-kombetare-shkolla-qender-komunitare-ministri-hoxha-punojme-se-bashku-per-te-ndertuar-shkolla-e-institucione-te-sigurta/>

¹⁶ Agjencia Telegrafike Shqiptare (2023), “Paketa “Siguria në shkolla”, Balla: Objektiv, parandalimi i kriminalitetit tek të rinjtë,” marrë nga <https://ata.gov.al/2023/12/18/paketa-siguria-ne-shkolla-balla-objektiv-parandalimi-i-kriminalitetit-tek-te-rinjte/>

Brezi i Rrezikuar: Rritja e Dhunës mes të Rinjve në Shqipëri

Qeveria ka njoftuar gjithashtu për planin e instalimit të kamerave për të monitoruar institucionet arsimore.¹⁷ Sistemi, i modeluar sipas atij që përdoret në Emiratet e Bashkuara Arabe, është krijuar për të mundësuar monitorimin në kohë reale të ambienteve shkollore. Institucionet pretendojnë se kjo qasje ka çuar në uljen e bullizmit dhe dhunës. Megjithatë, provat empirike që mbështesin efektivitetin e teknologjisë së monitorimit në parandalimin e dhunës në shkolla janë të kufizuara. Sipas një raporti të vitit 2023 nga Sindikata e Lirive Civile të Amerikës, kamerat e monitorimit ishin në funksion gjatë 8 prej 10 sulmeve më vdekjeprurëse në ambientet shkollore në Shtetet e Bashkuara në dekadat e fundit, dhe nuk arritën t'i parandalonin ato.¹⁸ Më e rëndësishmja, teknologjitë e monitorimit me kamera kanë treguar se shkaktojnë dëme të konsiderueshme ndaj nxënësve, duke shkelur privatësinë, minuar besimin mes nxënësve dhe stafit shkollor, duke ushqyer frikë, si dhe duke kriminalizuar sjelljen e të rinjve.¹⁹

3. PERSPEKTIVA

Në këtë kuadër, është e qartë se siguria e të rinjve në Shqipëri kërkon më shumë se ndërhyrje afatshkurtra dhe të izoluara. Një qasje sistematike e bazuar në të dhëna është shumë e nevojshme, e cila shqyrton format, shkaqet rrënjësore dhe faktorët që mundësojnë dhunën mes të rinjve dhe veprat penale të pa-raportuara ndër të miturit, veçanërisht brenda ambienteve shkollore. Kjo do të thotë mbledhjen e të dhënave të besueshme, angazhimin e aktorëve kyç dhe hartimin e rekomandimeve të bazuara në prova, në mënyrë që të shkohet drejt përmirësimit të mekanizmave të raportimit të dhunës (krimeve), rritur besimin tek aktorët institucionalë dhe ndërtuar një mjedis më të sigurt dhe gjithëpërfshirës për të rinjtë. Vetëm përmes të kuptuarit të plotë të dinamikave të dhunës mes të rinjve, forcimit të koordinimit institucional, investimit në masat parandaluese dhe promovimit të qëndrueshmërisë mes të rinjve, Shqipëria mund të fillojë të adresojë këtë kërcënim në rritje ndaj shoqërisë dhe stabilitetit të vendit.

¹⁷ Agjencia Telegrafike Shqiptare (2024), “Rama: Marrëveshje me Emiratet Arabe për monitorimin me kamera të shkollave,” marrë nga <https://ata.gov.al/2024/11/26/rama-marreveshje-me-emiratet-arabe-per-monitorimin-me-kamera-te-shkollave/>

¹⁸ Sindikata e Lirive Civile të Amerikës, “Distopia Digjitale: Rreziku nga Blerja e Asaj që Shitet nga Industria e Mbikëqyrjes EdTech,” 2023, marrë nga https://assets.aclu.org/live/uploads/publications/digital_dystopia_report_aclu.pdf

¹⁹ Po aty.